

K.B.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 19369 Prot

Lezhë, më 06/12 /2022

VENDIM

Nr. 129, Datë 02.12 .2022

**“PËR
MIRATIMIN E GJERGJ NDUE DODA SI SUBJEKT PËRFITUES PËR GRANTE
RINDËRTIMI PËR BANESA NË NDËRTEZA (PALLATE) ME SHKALLË DËMTIMI
DS4 DHE DS5 SIPAS ANALIZAVE TË THELLUARA TË INSTITUTIT TË
NDËRTIMIT NË BASHKINË LEZHË DHE STRUKTURËS SË BANIMIT
PËRKATËSE”**

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës, nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nenit 29, pika 1, nenit 54, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, nenit 3, pika 23, nenit 7, pika 1, nenit 30, nenit 42, pika 1, shkronjat “b” dhe “d”, të ligjit nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civile”, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.750, datë 27.11.2019 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.904, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit”, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.329, datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësia natyrore ose fatkeqësitë e tjera të shkaktuara nga veprimet njerëzore”, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.5, datë 06.01.2020 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model”, i ndryshuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.282, datë 09.04.2020 “Për disa ndryshime në vendimin nr.5, datë 06.01.2020, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model”, VKB nr.79, datë 25.06.2020 “Për miratimin e vertetimit të lëshuar nga Kryetari i Fshatit dhe Administratori i Njësisë Administrative, si dhe dokumentacionit tjetër plotësues, që vertetojnë posedimin dhe gëzimin e vazhduar të banesave, si dhe vertetimit të legalizimit dhe formularit të aplikimit, si dokumentacion që provojnë pronësinë e objektit për aplikuesit për programin e rindërtimit”, VKB nr. 22, datë 14.02.2020 “Për miratimin e manualit për procedurat e përfitimit

nga programet e procesit të rindertimit për strehim”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshillit i Bashkisë Lezhë,

VENDOSI:

1. Miratimin e Gjergj Ndue Doda si subjekt përfitues për grante rindërtimi për banesa në ndërtesa (pallate) me shkallë dëmtimi DS4 dhe DS5 sipas analizave të thelluara të Institutit të Ndërtimit në Bashkinë Lezhë dhe strukturës së banimit përkatëse, sipas aneksit nr.1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

**SEKRETARI
FLORIDA ÇUNAJ**



**KRYETARI
NDUE LULI**



Bashkia Lezhe


Lagjja Gurra

SUBJEKTI QË PËFITON DHE STRUKTURA PËRKATËSE E BANIMIT

Nr.	Emer Atësi Mbiemer	Numri I Identitetit	Struktura e banimit që përfiton
1	Gjergj Ndue Doda	H20822067L	1+1

KRYETARI

Pjerin Ndreu





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PREFEKTI I QARKUT LEZHË
SEKTORI I ZHVILLIMIT URBAN

Prot 1936 S/
dt 14.12.22

K.B.

Nr. 885/19 Prot.

Lezhë, më 14.12.2022

Lënda : Konfirmim vendimi

KËSHILLIT TË BASHKISË LEZHË

Lezhë

Për dijeni: KRYETARIT TË BASHKISË LEZHË

Lezhë

Bazuar në ligjin Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, neni 16, pika 2 gërma “b”, në ligjin nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 8, pika 2, neni 9, pika 1, nënpika 1.1, gërma “b”, neni 13, pika 2, neni 29, pika 1, neni 54, neni 55, pika 2 dhe 6, në ligjin nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”, në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 750 datë 27.11.2019 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë”, të ndryshuar, në ligjin nr.97/2019 “Për miratimin e Aktit Normativ me fuqinë e ligjit nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.904, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit”, në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.5, datë 6.01.2020 “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për përfitimet nga program i granteve të rindërtimit dhe projektet model”, i ndryshuar, **konfirmoj bazueshmërinë ligjore** të vendimit nr.129, datë 02.12.2022 të Këshillit të Bashkisë Lezhë “Për miratimin e Gjergj Ndue Doda si subjekt përfitues për grante rindërtimi për banesa në ndërtesa (pallate) me shkallë dëmtimi DS4 DHE DS5 sipas analizave të thelluara të Institutit të Ndërtimit në bashkinë Lezhë dhe strukturës së banimit përkatëse”.

P R E F E K T I

Gjergj PRENDI

